



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**Kom.Dh.Shk.II.nr.962/2024**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e shkallës së dytë**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar e kolegjit, Krenar Berisha dhe Dren Rogova, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit të masës së sigurimit Operatori Ekonomik "AL-BER" Sh.p.k, me seli ne Suhareke, me drejtor - administrator F.G., te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Ruzhdi Gashi me seli te zyrës ne Suhareke, kundër kundërshtarit të sigurimit Ministria e Punëve te Brendshme - Departamenti i Prokurimit, me seli ne Prishtine, te cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura Shtetërore, Avokate Naime Abazi, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të sigurimit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e shkallës së parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KE.nr.317/23 e datës 01.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 03.05.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e propozuesit të masës së sigurimit Operatori Ekonomik "AL-BER" Sh.p.k, me seli ne Suhareke, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.317/23 e datës 01.12.2023, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KE.nr.317/23 e datës 01.12.2023, në piken I të dispozitivit të aktvendimit e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar propozimin e propozuesit të masës së sigurimit Operatori Ekonomik "AL-BER" Sh.p.k, me seli ne Suhareke, i paraqitur ndaj kundërshtarit të sigurimit Ministria e Punëve te Brendshme - Departamenti i Prokurimit, me seli ne Prishtine, me te cilin ka kërkuar, me te cilën ka kërkuar qe te detyrohet kundërshtari i masës Ministria e Punëve te Brendshme - Departamenti i Prokurimit, me seli ne Prishtine, qe te ndaloj konfiskimin e sigurimit te ekzekutimit te tenderit me nr. te polices Seria / 110503, shuma prej 45,000.00 Euro, te lëshuar nga Kompania e Sigurimeve ELSIG Sh.A, te datës 03.02.2023, te vlefshme deri me 10.03.2023 si dhe REFUZOHET ne teresi si i pabazuar propozimi i propozuesit te masës se sigurimit "AL-BER" Sh.p.k, me seli ne Suhareke, me te cilën ka kërkuar qe te ndërmarrë veprime qe kane te bëjnë me diskualifikimin e paditëses / propozueses Operatori Ekonomik "AL-BER" Sh.p.k, tek Organi Shqyrtues i Prokurimit, si dhe veprime tjera qe kane te bëjnë me ndalimin e punimeve ne mënyrë te njëanshëm dhe ne kundërshtim me ligjin, ndërsa ne piken e II te dispozitivit ka vendosur qe procedura ne këtë çështje juridike do te vazhdohet sipas rregullave te procedurës kontestimore dhe ne pajtim me planin e punës se gjykatës, kurse ne piken

e trete qe secila pale ndërgjyqëse i bart shpenzimet e veta te shkaktuar deri ne këtë stad te procedurës.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë propozuesi i sigurimit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e shkallës së dytë, aktvendimin KE.nr.317/23 e datës 01.12.2023 ta anuloj dhe të aprovohoj propozimi i propozuesit apo lenden te kthej ne rivendosje dhe rigjykim, ne gjykatën e shkalles se pare.

Kundërshtari i sigurimit nuk ka ushtruar përgjigje ne ankesë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesja e masës së sigurimit me datë 07.04.2023, ka paraqitur padi, kundër të paditurës, me propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Ne propozimin për caktimin e masës ka kërkuar që të te detyrohet kundërshtari i masës Ministria e Punëve te Brendshme - Departamenti i Prokurimit, me seli ne Prishtine, qe te ndaloj konfiskimin e sigurimit te ekzekutimit te tenderit me nr. te polices Seria / 110503, shuma prej 45,000.00 Euro, te lëshuar nga Kompania e Sigurimeve ELSIG Sh.A, te datës 03.02.2023, te vlefshme deri me 10.03.2023 si dhe me te cilën ka kërkuar qe te ndërmarrë veprime qe kane te bëjnë me diskualifikimin e paditëses / propozueses Operatori Ekonomik "AL-BER" Sh.p.k, tek Organi Shqyrtues i Prokurimit, si dhe veprime tjera qe kane te bëjnë me ndalimin e punimeve ne mënyrë te njëanshëm dhe ne kundërshtim me ligjin, ndërsa ne piken e II te dispozitivit ka vendosur qe procedura ne këtë çështje juridike do te vazhdohet sipas rregullave te procedurës kontestimore dhe ne pajtim me planin e punës se gjykatës, kurse ne piken e trete qe secila pale ndërgjyqëse i bart shpenzimet e veta te shkaktuar deri ne këtë stad te procedurës. Gjykata e shkallës së parë, lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë ka mbajtur seancën dëgjimore dhe ndërgjyqësit i kanë paraqitur pretendimet e tyre sa i përket bazueshmërisë së propozimit dhe pas përfundimit të seancës gjyqësore, ka marr aktvendimin e ankimuar duke u bazuar në dispozitën e nenit 297 par.1 pika a) dhe b) dhe nenit 301 të LPK-së, si dhe duke arsyetuar aktvendimin e ankimuar se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurisë.

Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë e mori këtë qëndrim juridik sepse sipas Nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se:” *Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se*

*propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij , dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshihjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.*

Bazuar në dispozitat e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit duhet të plotësohen kushtet ligjore, sipas të cilave propozuesi i sigurimit duhet ta bëjë të besueshme ekzistimin e kërkesës si dhe ta bëjë të besueshme faktin se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së tij, andaj në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë, me vendimin e atakuar, me të drejtë ka vendosur se nuk janë përmbushur konditat ligjore sipas nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, andaj edhe ka refuzuar kërkesën për caktimin e masës së sigurimit.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, me një kujdes të shtuar i ka analizuar edhe pretendimet tjera ankimore në raport me provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe erdh në përfundim se këto pretendime tani për tani nuk qëndrojnë, sepse masa siguroese është mjet për parandalimin e ndryshimit të gjendjes ekzistuese të kërkesëpadisë dhe kjo masë mund të caktohet po që se propozuesi i masës e bënë të besueshme të drejtën e tij subjektive dhe paraqet prova apo rrethana që e bindin gjykatën se ekziston rreziku serioz se kundërshtari i sigurimit me veprimin apo mos veprimin e tij mund t'ia pamundëson apo vështirëson dukshëm realizimin e kërkesëpadisë.

Në rastin konkret propozuesi i masës së sigurimit nuk ka ofruar prova konkrete me të cilën e do të bënte të besueshme kërkesën apo të drejtën subjektive, kjo për faktin se në këtë rast në baze të deklarimeve të Kompanisë ELSG, deklarata e cila gjendet në shkresat e lëndës me numër serik 105483, vlerësoi se njëjta nuk është lëshuar nga Kompania në fjale, pra propozuesi nuk ka arritur t'ia dëshmojë Gjykatës me provat që gjendet në shkresat e lëndës se dokumenti i prezantuar në emër të sigurimit të tenderit me nr. 105483, ka qenë dokument valid. Prandaj për vlerësimin e gjykatës propozuesi nuk e bere të besueshme të drejtën e tij subjektive ngase prona me të cilën ka propozuar të drejtohet kërkesa për masën e sigurimit është prone e kundër propozuesit të parë, e po ashtu nuk e ka bere të besueshme se kundërshtarit të sigurimit vërtetë mund të pamundësoj apo vështirësoj dukshëm realizimin e kërkesës në ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do mund të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të mund të ndikonte negativisht në të drejtat e propozueses së sigurimit, se do të ndikonte në pamundësinë e realizimit i kërkesës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, sepse e njëjta me të drejtë nga vlerësimi i provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se nuk janë përmbushur konditat ligjore të parapara me dispozitën e nenit 297.1 nën pikën a) dhe b), për caktimin e masës së sigurisë.

Sa i përket pretendimit ankimor lidhur me faktin se gjykata në shkallë të parë me rastin e refuzimit të kërkesës për caktimin e masës së sigurisë, nuk ka vërtetuar faktet dhe pretendimet e

propozuesit, Dhoma e Shkallës së Dytë konstaton se pretendimet e tilla do të shqyrtohen në procedurën kontestimore sipas padisë.

Andaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, sepse e njëjta me të drejtë nga vlerësimi i provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se nuk janë përmbushur konditat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) dhe para.2 të LPK-së, për caktimin e masës së sigurisë.

Andaj, bazuar në të lartcekurat dhe në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke vërtetuar vendimin e gjykatës së shkallës ë parë.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhomat e shkalles së dytë,**  
**Kom.Dh.Shk.II.nr.962/2024, dt.03.05.2024**

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari**  
**Faton Bajrami, d.v**